

RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E
ORTAKUT/AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT DHE
VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE TË ORTAKUT/AKSIONARIT QË
KONTROLLON INTERESAT E TË LICENCUARIT SI MJETE PËR GARANTIMIN E
PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT/EVE NDAJ TË TRETËVE**

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në përputhje me nenin 20, germa “g” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe kushtet e licencave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën, dokumentacionin e kërkuar dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për të licencuarit, që paraqesin kërkesën për:

- a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;
- b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;
- c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët paraqesin kërkesën, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore, frazat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) “Ligji për energjinë” është ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- b) “Ligji për gazin natyror” është ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.
- c) “Bordi i ERE-s” është organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- d) “ERE” është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
- e) “Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit të energjisë dhe ligjit të gazit natyror.
- f) “I licencuar” është një person i cili gëzon të drejtën dhe është i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike apo të gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
- g) “Procedurë” është tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- h) “Transferim kuotash/aksionesh” është çdo veprim me anë të të cilit krijohet një marrëdhënieje shitjeje, dhurimi, dhënieje me qira, transferimi, hipotekimi, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër i kuotave apo aksioneve të të licencuarit, kur nga ky transferim ndryshon ortakut/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit.
- i) “Ortakut/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit” është ortakut apo aksionari që zotëron përqindjen e nevojshme për të përcaktuar vendimmarrjen në shoqërinë e licencuar. Për çfarëdolloj transferimi kuotash apo aksionesh që ndryshon këtë përqindje është e nevojshme të merret autorizimi nga ERE.

**PJESA E DYTË
PROCEDURAT E PARAQITJES SË NJË KËRKESË PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE**

Neni 5

Paraqitja e kërkesës

1. Procedura për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, fillon me paraqitjen nga një i licencuar i kërkesës për një ose disa nga rastet e mëposhtme:
 - a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit;
 - b) ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit;
 - c) vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakut/aksionari që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar.
2. Kërkesa dhe informacioni bashkëlidhur kërkesës duhet të jenë nënshkruar nga personi ose personat që kanë kompetencën për përfaqësimin e të licencuarit.
3. I licencuari mund të caktojë dhe një përfaqësues ligjor për të paraqitur në ERE aplikimin, së bashku me dokumentacionin përkatës, dhe për të ndjekur procedurën deri në dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin, sipas kërkesës. Në këtë rast duhet të paraqitet në ERE prokura ose autorizimi i dhënë nga i licencuari për përfaqësimin e tij.
4. Dokumentacioni i paraqitur nga i licencuari duhet të jetë në gjuhën shqipe, original, fotokopje e noterizuar, ose me vulë elektronike. Dokumentet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së kërkesës. I gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të depozitohet dhe në një kopje elektronike (CD ose USB).
5. Pjesët e dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim duhet të specifikohen në kërkesë, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre. Përndryshe konsiderohet se kërkesuesi nuk e kërkon një kufizim të tillë.

Neni 6

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor, duhet përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin/dokumentacionin si më poshtë:
 - a) emrin e plotë të të licencuarit;
 - b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e e-mailit;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të statusit ligjor, duke përcaktuar dhe afatin e këtij ndryshimi;
 - d) ekstraktin historik të regjistrit tregtar të të licencuarit.
2. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 7

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:
 - a) emrin e plotë të të licencuarit;
 - b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e e-mailit;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit;
 - d) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar;
 - e) një përshkrim të kandidatit të propozuar për të kontrolluar interesat e shoqërisë, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë (në rastin kur kontrollues i interesave të të licencuarit bëhet një person juridik/fizik);
 - f) informacion të detajuar mbi kontributin financiar që do të japë në ushtrimin e aktivitetit kandidati i propozuar për të kontrolluar interesat e të licencuarit;
 - g) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi ndaj të tretëve.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:
 - a) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit, si dhe ekstraktet historike të regjistrit tregtar të të gjithë ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;
 - b) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të kandidatit të propozuar për kontrollin e interesave të shoqërisë, në rastet kur ky është një person juridik/fizik. Në rastet kur kontrollues i interesave të të licencuarit do të bëhet një shoqëri e huaj, duhet të depozitohet ekstrakti me të dhënat tregtare përkatëse të regjistruara për këtë shoqëri, i përkthyer, i pajisur me vulë apostile dhe vërtetim përkthimi;
 - c) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit për kryerjen e transferimit të kuotave/aksioneve, transferim i cili ndryshon dhe ortakun/aksionarin që kontrollon interesat e të licencuarit, si dhe të organeve përkatëse drejtuese të ortakëve/aksionarëve të të licencuarit, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;
 - a) vendimi i organeve drejtuese të shoqërisë tek e cila do të kryhet transferimi, ku të shprehet pranimi i këtij transferimi. Në rastet kur transferimi do të kryhet te një ortak individ, miratimi me shkrim i këtij të fundit për pranimin e transferimit. Në të dyja rastet duhet të shprehet dhe gatishmëria e kandidatit tek i cili do të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
 - d) marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën, në rastet e barrësimit, hipotekimit etj., të kuotave/aksioneve;
 - e) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;
 - f) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit kryesor të të licencuarit.
3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 8

Përmbajta e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm, për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër)

1. Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve (hipotekim, barrësim, lënie peng ose çfarëdolloj disponimi tjetër), kur nga ekzekutimi i këtij detyrimi rezulton se ndryshon ortakun/aksionarin që kontrollon interesat e shoqërisë së licencuar, duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

- a) emrin e plotë të të licencuarit;
 - b) adresën e saktë të të licencuarit ose/dhe personit të autorizuar për të ndjekur këtë procedurë në ERE, ku të përfshihet edhe numri i telefonit dhe adresa e e-mailit;
 - c) një përshkrim nga i licencuari mbi arsyet vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve;
 - d) një përshkrim të detyrimeve me të cilat ngarkohet i licencuari dhe pasojat në rast të moszekutimit të detyrimit sipas afateve dhe përcaktimeve të përshkruara në marrëveshjen paraprake;
 - e) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi tjetër ndaj të tretëve.
2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitohet në ERE dhe dokumentacioni si vijon:
- a) ekstrakti historik i regjistrimit tregtar të të licencuarit;
 - b) vendimi i organeve drejtuese të të licencuarit vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve;
 - c) marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën;
 - d) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e autoritetit shtetëror;
 - e) vendimin gjyqësor të formës së prerë (në rast se ka), për vendosjen e kuotave/aksioneve të të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve.
3. I licencuari duhet të ketë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Neni 9

Shqyrtimi i aplikimit

1. Shqyrtimi i aplikimit për dhënien e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e tij.
2. Në çdo rast, por jo më vonë se 5 ditë pune nga paraqitja e kërkesës, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të plotësojë dokumentacionin e konstatuar të munguar nga aplikimi ose depozitimimin e informacionit shtesë brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mungesës së dokumentacionit/informacionit në aplikimin e tij.
3. Në rast se nuk plotëson dokumentacionin/informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, kërkesa e të licencuarit për dhënien e autorizimit nga ERE quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit bashkë me aktet e tjera.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

4. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk është dërguar sipas kërkesave të nenit 6, 7 apo 8 të kësaj rregulloreje, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni fillon nga dita e depozitimit të dokumentacionit/informacionit të plotë nga kërkuesi.
5. Pas analizës përfundimtare të dokumentacionit të depozituar sipas përcaktimeve dhe afateve të kësaj rregulloreje, struktura përgjegjëse i paraqet Bordit një relacion, duke propozuar dhënien ose jo të autorizimit nga ERE, të shoqëruar me arsyetimet përkatëse, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.
6. Në rast refuzimi të kërkesës, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda 7 ditëve pune nga marrja e vendimit.
7. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.
8. Në rastet e dhënies së autorizimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e statusit ligjor apo transferimin e kuotave, i licencuari duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, ku të reflektohet ky ndryshim/transferim.

Neni 10

Vendimmarrja e Bordit

1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-s do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, duke e bazuar vendimin e tij në:
 - a) plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion/dokumentacion shtesë të ERE-s;
 - b) relacionin e hartuar nga personi/personat e ngarkuar nga struktura përgjegjëse;
 - c) efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transsferimit në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të aktivitetit të licencuar;
 - d) gatishmërinë e kandidatit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
 - e) gjendjen financiare të kandidatit të propozuar për transferim për të vazhduar me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

2. Bordi mund të japë dhe një vendim me kusht, rast pas rasti, në përputhje me specifikat e aplikimit, duke përcaktuar dhe një afat kohor për plotësimin e këtij kushti.

Neni 11

Njoftimi i vendimit

1. Në përfundim të procedurës për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, ERE do të njoftojë të licencuarin sipas përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.
2. Për këtë vendimmarrje do të njoftohet dhe autoriteti shtetëror përgjegjës në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE për një subjekt koncesionar apo që ka një autorizim nga autoriteti shtetëror përgjegjës.
3. Vendimi i ERE-s, i dhënë sipas kësaj rregulloreje, botohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
4. Kundër vendimit të Bordit të ERE-s, për miratimin apo refuzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, dhe brenda 45 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, për subjektet e licencuara në një nga veprimtaritë e sektorit të gazit natyror

Neni 12

E drejta për t’u informuar mbi përmbajtjen e regjistrin të autorizimeve të dhëna nga ERE

1. ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit regjistrin e autorizimeve, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Në këtë regjistër përfshihen të dhënat si më poshtë:
 - a) emri i të licencuarit;
 - b) NUIS-i (numri unik i identifikimit të subjektit);

Miratur me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021

- c) numri dhe data e vendimit të Bordit të ERE-s për dhënien e autorizimit përkatës;
 - d) lloji i autorizimit të dhënë.
3. E drejta e aksesit në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.
4. Informacioni konfidencial do të trajtohet në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13 Ndryshime të rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet nga Bordi i ERE-s dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.